



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.635/11 prot.

Datë 27.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 557/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 497/2026, datë 10.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
- Ankimues:** Operatori BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k me NIPT M01406022R dhe NIPT K82020002A, me adresë: Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2.
- Autoriteti Kontraktor** Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit 2 Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë

*së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi çështjen dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 10.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 497/2026, ku vendosi:

*“1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*

*2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*

*3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

*3. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k.*

*4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

*5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 3851/1 prot., datë 24.04.2026, protokolluar me tonën nr. 635/8 prot., datë 24.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 497/2026, datë 10.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 3851/1 prot., datë 24.04.2026, protokolluar me tonën nr. 635/8 prot., datë 24.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 497/2026, datë 10.04.2026, të Komisionit të Prokurimit

Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 3851/1 prot., datë 24.04.2026, protokolluar me tonën nr. 635/8 prot., datë 24.04.2026, dhe pas verifikimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezulton se autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, ka rivlerësuar procedurën e sipërcituar në përputhje me vendimin Nr. 497/2026, datë 10.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 497/2026, datë 10.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

